



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 27 shkurt 2012  
Ref.Nr.:RK201/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 26/10**

Parashtrues

**Emin Behrami**

**VLERËSIM I KUSHTETUTSHMËRISË**

së

**Vendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 14/2008,  
të 10 tetorit 2008,**

dhe

**Vendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 260/2008,  
të 2 korrikut 2008**

**GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

**Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues është z. Emin Behrami nga komuna e Vushtrrisë.

## **Vendimet e kontestuara**

2. Parashtruesi i konteston Aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 14/4008, të 10 tetorit 2008, dhe C. nr. 260/2008, të 2 korrikut 2008, të cilat iu dorëzuan më 4 korrik 2008.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi pohon për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 27 prill 2010.
6. Më 27 prill 2010, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. 26/10, e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 26/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.
7. Më 24 gusht 2010, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën Komunale në Vushtrri për këtë kërkesë, ajo u përgjigj më 13 shtator 2010.
8. Më 21 dhjetor 2010, Gjykata Kushtetuese kërkoi dokumente shtesë nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë lidhur me këtë rast, dhe ajo u përgjigj më 28 dhjetor 2010.
9. Më 3 maj 2011, një njoftim iu dërgua Gjykatës Komunale në Vushtrri lidhur me statusin e lëndës Ac. Nr. 14/2008.

## **Përmbledhje e fakteve**

10. Parashtruesi pohoi për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese në lidhje me dy çështje të ndërlidhura: (1) çështja e të drejtës së pronës lidhur me ngastrën kadastrale dhe shtëpinë e ndërtuar në të; dhe (2) çështja e të drejtës së pronës lidhur me çezmën që gjendet në ngastrën e kontestuar kadastrale.

## **Çështja e pronës lidhur me ngastrën kadastrale dhe shtëpinë e ndërtuar në të**

11. Më 22 dhjetor 1977, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin C. nr. 357/77, vendosi t'ia akordonte parashtruesit të drejtën për gjysmën e ngastrës kadastrale nr. 3001/12, që gjendet tek vendi i quajtur "Selishte" në Vushtrri.
12. Më 31 mars 1978, Sekretariati për Ekonomi dhe Çështje Komunale në Vushtrri, me Vendimin 03-nr. 353-19, i dha parashtruesit leje ndërtimore për atë ngastër kadastrale.

13. Më 24 janar 1979, parashtruesi u pajtua me babanë e vet për ta ndarë pronën familjare. Parashtruesi mori ngastrën kadastrale nr. 3001/14, që përmbante një shtëpi dhe një kopsht.
14. Më 15 dhjetor 1980, Kryetari i Bashkësisë Islame në Prishtinë i dha parashtruesit një hua në shumë prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) dinarëve për ta përfunduar ndërtimin e shtëpisë së tij në ngastrën e sipërpërmendur kadastrale.
15. Më 5 dhjetor 1994, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin P. br. 110/94, ia akordoi të drejtën babait të parashtruesit dhe familjes së tij për të shfrytëzuar pjesë të shtëpisë që posedoheshin nga parashtruesi.
16. Më 6 prill 1995, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Aktgjykimin GZH-br. 132/95, e miratoi Aktgjykimin P. br. 110/94, të Gjykatës Komunale në Vushtrri.
17. Më 12 maj 1995, babai i parashtruesit kërkoi nga Gjykata Komunale në Vushtrri që t'ia caktonte të drejtën në pronën e përbashkët për shtëpinë që zotërohej nga parashtruesi.
18. Më 8 nëntor 1995, Gjykata Komunale, me Vendimin P. br. 35/95, e miratoi kërkesën kundër të cilës parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.
19. Më 17 maj 1996, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Vendimin GZH. br. 43/96, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar.
20. Më 28 maj 1996, babai i parashtruesit dhe familja e tij paraqitën kërkesë në Gjykatën Komunale në Vushtrri për iniciimin e procedurës përmbareme lidhur me Vendimin P. br. 35/95, të 8 nëntorit 1995, dhe Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, GZH. br. 43/96, të 5 qershorit 1996.
21. Më 7 tetor 1996, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Vendimin I-164/96, e hodhi poshtë si të pabazuar kundërshtimin e parashtruesit kundër urdhrit për përmbareme.
22. Më 23 shkurt 1997, Gjykata Supreme e Serbisë, me Vendimin Rev. 3277/96, i abrogoi këto vendime: P. br. 110/94, të 5 dhjetorit 1994; GZH-br. 132/95, të 6 prillit 1995; P. br. 35/95, të 8 nëntorit 1995; GZH. br. 43/96, të 17 majit 1996; dhe I. br. 164/96, të 7 tetorit 1996, dhe ia ktheu vendimet e sipërpërmendura Gjykatës Komunale në Vushtrri për rigjykim.
23. Më 17 prill 1997, parashtruesi kërkoi nga Gjykata Komunale në Vushtrri pezullimin e procedurës përmbareme në rastin P. br. 164/96.
24. Më 13 maj 1997, Gjykata Komunale, me Vendimin I. br. 142/97, e anuloi procedurën përmbareme kundër parashtruesit.
25. Si rrjedhojë, babai i parashtruesit dhe familja e tij i zënë pjesë të shtëpisë së parashtruesit.
26. Më 17 qershor 1997, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën Komunale në Vushtrri, me të cilën kërkonte vënien e masave të përkohshme kundër zënies së shtëpisë nga babai i tij dhe familja e tij. Gjykata në fjalë gjoja nuk e mori parasysh këtë ankesë.
27. Më 17 korrik 1997, babai i parashtruesit dhe familja e tij parashtruan ankesë në Gjykatën Komunale në Vushtrri, me të cilën kërkonin vënien e masave të përkohshme kundër parashtruesit.

28. Më 29 korrik 1997, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Vendimin P. br. 138/97, caktoi masën e përkohshme kundër parashtruesit, duke e lejuar babain e parashtruesit dhe familjen e tij të kyçeshin në rrjet elektrik dhe ujësjellës në pjesën e shtëpisë të banuar nga ata, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
29. Më 20 gusht 1997, parashtruesi parashtrroi ankesë në gjykatën e njëjtë, me të cilën kërkonte që ajo ta shqyrtonte Vendimin P. br. 138/97.
30. Më 7 dhjetor 1998, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Vendimin P. br. 119/97, e legalizoi zënien e 2/3 së shtëpisë së parashtruesit nga babai i parashtruesit dhe familja e tij dhe caktoi gjobë ose paraburgim kundër parashtruesit dhe djemve të tij.
31. Pas padisë së ngritur nga babai i parashtruesit më 17 dhjetor 1998, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Vendimin P. br. 220/97, vendosi që ngastra e kontestuar kadastrale ishte pronë e përbashkët e familjes dhe se parashtruesi duhet ta njohë dhe lejojë regjistrimin e ngastrës kadastrale në fjalë në Zyrën Kadastrale në Vushtrri. Ky vendim i është dorëzuar parashtruesit më 21 janar 1999.
32. Më 1 janar 1999, parashtruesi parashtrroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë kundër Vendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, P. br. 119/97, por procedura u ndërpre për shkak të ndodhive që ishin duke u zhvilluar në Kosovë në atë kohë.
33. Më 7 prill 2000, parashtruesi ndërmori masa ligjore në Gjykatën Komunale në Vushtrri kundër babait të tij dhe familjes së tij, duke kërkuar që atij t'i kthehej prona e paluajtshme.
34. Me Aktgjykimin K-nr. 20/2000, të 29 qershorit 2000, Gjykata Komunale në Vushtrri e miratoi padinë e parashtruesit dhe i urdhëroi babait të parashtruesit dhe familjes së tij ta lironin pjesën nën kulm në katin e dytë të shtëpisë.
35. Pas ankesës së babait të parashtruesit, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Vendimin Ac. Nr. 26/2001, të 9 janarit 2001, e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, K-nr. 20/2000, të 29 qershorit 2000, dhe ia ktheu lëndën të njëjtës gjykatë për rigjykim.
36. Pasi verifikoi që ngastra e kontestuar kadastrale bashkë me shtëpinë e ndërtuar në të kishin qenë pronë e përbashkët gjatë bashkësisë familjare të ndërgjyqësve, më 4 shtator 2001, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin K. nr. 63/2001, e miratoi padinë e babait të parashtruesit dhe të familjes së tij, dhe e refuzoi padinë e parashtruesit se ai ishte pronari i vetëm i ngastrës kadastrale dhe i shtëpisë të kontestuar.
37. Më 10 tetor 2002, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Aktgjykimin, Ac. nr. 28/2002, e miratoi Aktgjykimin K. nr. 63/2001 dhe e refuzoi ankesën e parashtruesit se është pronari i vetëm i ngastrës kadastrale dhe i shtëpisë së kontestuar.
38. Më 24 prill 2003, Gjykata Supreme, me Vendimin Rev. nr. 19/2003, e pranoi revizionin e parashtruesit dhe e anuloi Aktgjykimin Ac. Nr. 28/2002, të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, dhe Aktgjykimin C. nr. 63/2001, të Gjykatës Komunale në Vushtrri, dhe ia ktheu lëndën gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.
39. Më 16 dhjetor 2003, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin K. nr. 92/03, e miratoi padinë e babait të parashtruesit dhe të familjes së tij dhe konfirmoi se ngastra kadastrale dhe shtëpia e kontestuar janë pronë e përbashkët e bashkësisë familjare, dhe se parashtruesi ishte i obliguar ta pranonte këtë aktgjykim dhe ta lejonte regjistrimin e

pronës së kontestuar në Zyrën Kadastrale në emër të babait të parashtruesit dhe familjes së tij.

40. Më 4 janar 2005, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Vendimin Ac. nr. 49/04, e miratoi ankesën e parashtruesit, e anuloi Aktgjykimin K. nr. 92/03, të Gjykatës Komunale në Vushtrri, dhe ia ktheu lëndën të njëjtës gjykatë për rigjykim.
41. Më 22 dhjetor 2005, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin C. nr. 447/05, e miratoi padinë e babait të parashtruesit dhe familjes së tij, dhe konfirmoi se ngastra kadastrale dhe shtëpia e kontestuar ishin pronë e përbashkët e bashkësisë familjare të babait të parashtruesit dhe parashtruesit.
42. Më 27 dhjetor 2007, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Vendimin Ac. nr. 61/2006, e anuloi Aktgjykimin C. nr. 447/05, të Gjykatës Komunale në Vushtrri dhe ia ktheu lëndën gjykatës në fjalë për rigjykim.
43. Më 10 tetor 2008, Gjykata Komunale në Vushtrri e ftoi babain e parashtruesit në një seancë dëgjimore për këtë rast, me ç'rast ai dha një deklaratë, e cila u evidentua në regjistrin e gjykatës nën C. nr. 14/2008, dhe iu dërgua Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, e cila procedoi këtë lëndë nën numrin e ri Ac. nr. 91/08.
44. Më 7 prill 2009, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, në të cilën theksonte se Gjykata Komunale në Vushtrri, në seancën publike të 10 tetorit 2008, e cila përfundoi me Aktgjykimin C. nr. 14/2008 (shënim: procesverbali i asaj seance publike përmban vetëm deklaratat e babait të parashtruesit), nuk e ftoi as atë, as përfaqësuesin e tij ligjor si palë kundërshtarë, dhe nuk iu dërgua kopja e aktgjykimit në fjalë.
45. Më 8 qershor 2009, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, përmes të cilës kërkonte t'i dorëzohej Vendimi Ac. nr. 91/08, dhe ia tërhoqi vërejtjen gjykatës në fjalë se ai do të priste më së largu deri më 26 qershor 2009 që t'i dorëzohej vendimi.
46. Më 31 janar 2011, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ia dërgoi parashtruesit një njoftim lidhur me rastin Ac. nr. 91/08, i cili i ishte dërguar edhe Gjykatës Komunale në Vushtrri, në të cilin thuhej:

*“Me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë Ac. nr. 61/2006 të datës 27.12.2007 është prishur në tërësi aktgjykimi C. nr. 447/05 i datës 22.12.2005 i Gjykatës Komunale në Vushtrri dhe lënda i është kthyer të njëjtës për rigjykim dhe vendosje.*

*Nga dokumentet e lëndës shihet që Gjykata Komunale në Vushtrri (procesverbali i 10 tetorit 2008), pa seancë gjyqësore e ka thirrur vetëm Halil Qerimin (babanë e parashtruesit) dhe pa marrë masa përkatëse për rigjykim në përputhje me rekomandimet e dhëna në vendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë Ac. nr. 61/2006; lënda iu kthye përsëri Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.*

*“Gjykata Komunale në Vushtrri ishte e obliguar t'i thërriste ndërgjyqësit në seancën e rigjykimit në mënyrë që ata t'i parashtronin pretendimet e tyre dhe më pas të merrte vendim të mirëfilltë si rezultat i fakteve të vërtetuara në mënyrë të drejtë e të hollësishme në proces të rregullt gjyqësor. Vendimet është dashur t'u dërgoheshin palëve bashkë me këshillën juridike lidhur me ankesat në përputhje me kriteret juridike, vetëm atëherë lënda duhet t'i dërgohet Gjykatës së Qarkut për shqyrtim në shkallë të dytë”.*



*Bashkëngjitur me këtë parashtrësë ua përcjellim dokumentacionin komplet të lëndës Ac. nr. 14/2008 për rigjykim”.*

### **Çështja e çezmës**

47. Më 16 qershor 2008, parashtruesi ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Vushtrri kundër të paditurit (babait të parashtruesit dhe familjes së tij) mbi bazën se i padituri ka kryer pengim të posedimit në dëm të parashtruesit duke mos i lejuar djemtë e tij që ta vënin në funksion çezmën që gjendet në pjesën e ngastrës që i takon të paditurit.
48. Më 2 korrik 2008, Gjykata Komunale në Vushtrri, përmes Vendimit C. nr. 260/2008, e refuzoi padinë e parashtruesit si të pabazuar. Në pjesën e arsyetimit, Gjykata Komunale në Vushtrri theksoi se parashtruesi e ka humbur posedimin e çezmës së sipërpërmendur sepse që nga viti 2004 ai nuk ka ushtruar pushtet faktik mbi objektin e sipërpërmendur. Gjykata Komunale në Vushtrri nxori vendimin e vet në bazë të nenit 74 të Ligjit mbi marrëdhëniet pronësore juridike, Gazeta Zyrtare e ish-RSFJ-së, në të cilin thuhet që:

*“Posedimi humbet kur mbajtësi pushon të ushtrojë zotërimin faktik të sendit”.*

49. Më 7 korrik 2008, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Vendimit C. nr. 260/2008, me ç’rast u ankua se Gjykata Komunale në Vushtrri, përmes vendimit të sipërpërmendur, ka kryer shkelje të rëndë të dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore, vërtetim të gabueshëm të gjendjes faktike dhe zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

### **Pretendimet e parashtruesit**

#### **Lidhur me ngastrën kadastrale dhe shtëpinë e ndërtuar në të**

50. Parashtruesi pohon që Gjykata Komunale në Vushtrri, përmes Aktgjykimit C. nr. 14/2008, të 10 tetorit 2008, ia shkeli të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe me nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës, sepse ai nuk ishte ftuar nga gjykata e sipërpërmendur edhe pse ishte palë në procedurë.
51. Parashtruesi pohon që Gjykata Komunale në Vushtrri i ka injoruar të gjitha provat përkatëse ligjore që ai është pronar i vetëm i ngastrës kadastrale të kontestuar dhe i shtëpisë së ndërtuar në të, sepse gjykata e sipërpërmendur gjoja lejoi uzurpimin me dhunë të 2/3 së shtëpisë së parashtruesit.
52. Për më tepër, parashtruesi pohon që Gjykata Komunale në Vushtrri me qëllim i ka injoruar udhëzimet detyruese të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, me ç’rast Gjykata e Qarkut në Mitrovicë disa herë i ka anuluar aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Vushtrri për shkak të shkeljeve thelbësore të Ligjit për procedurën kontestimore, dhe ia ka kthyer lëndën për rigjykim gjykatës së sipërpërmendur.
53. Parashtruesi pohon që lënda e tij është në procedurë e sipër në gjykatat e rregullta që nga viti 1992, dhe ende nuk është zgjidhur për shkak të vonesave të qëllimshme nga Gjykata Komunale në Vushtrri.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

#### **Çështja e të drejtës së pronës**

54. Në rastin në fjalë, parashtruesi ankohet për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemi Gjyqësor], të Kushtetutës. Parashtruesi ankohet në veçanti për kohëzgjatjen e procedurave lidhur me padinë në të cilën përfshiheshin ai dhe anëtarët e familjes së tij, që gjoja filloi më 4 gusht 1992.
55. Megjithatë, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë dhe Ligj lidhur me ankesat e tij sipas Kushtetutës.
56. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që periudha që duhet të merret parasysh për të vendosur për kërkesën e parashtruesit nuk filloi të ecën më 4 gusht 1992, kur ishte parashtruar padia në të cilën përfshiheshin parashtruesi dhe babai i tij, por më 15 qershor 2008, kur Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyri në fuqi dhe përcaktoi juridiksionin e kësaj Gjykate për të vendosur për kërkesa sipas nenit 113 [Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.
57. Sa i përket nenit 113, Gjykata i referohet paragrafit 7, i cili thotë që "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*" Kjo do të thotë që, para se ta paraqiste kërkesën në këtë Gjykatë, parashtruesi është dashur së pari të ketë provuar ta marrë një vendim për objektin e çështjes së ankesave të tij nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë ankesat në gjykatën më të lartë, e cila ka juridiksion për këtë lëndë..
58. Gjykata thekson se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të cekën në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Nëse çështja ishte ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, Vendim i 28 prillit 2004).
59. Kjo Gjykatë përdori të njëjtin arsyetim kur nxori Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti KI-41/09, i 27 janarit 2010, dhe në Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor, Rasti Nr. 73/09, i 23 marsit 2010.
60. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesve të kërkesës u kërkohet t'i shterin vetëm mjetet juridike të cilat janë në dispozicion dhe efektive. Mjetet diskrecionale ose të jashtëzakonshme nuk duhet të shteren, për shembull, të kërkosh nga gjykata ta rishqyrtojë vendimin e vet (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Cinar kundër Turqisë, nr. 28602/95, Vendim i 13 nëntorit 2003).
61. Prandaj, sa i përket këtij rasti, Gjykata duhet të shqyrtojë së pari nëse, që nga 15 qershori 2008, kur u përcaktua juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për të vendosur për kërkesa, parashtruesi ka ngritur ankesa kushtetuese, të cilën është duke e parashtruar në këtë Gjykatë, në gjykatat e tjera që merren me rastin e tij, dhe, nëse nuk ka pasur

sukses, në Gjykatën Supreme, si instancë e fundit, apo nëse i ka shfrytëzuar mjetet e tjera juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.

62. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që më 20 qershor 2008, kur me sa duket rasti priste të zgjidhej në Gjykatën Komunale në Vushtrri, parashtruesi iu ankua Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë për sjelljen e gjyqtarëve të Gjykatës Komunale, në veçanti të Kryetarit të saj, duke i quajtur të korruptuar dhe shkelës të ligjit.
63. Më 1 gusht 2008, parashtruesi i shkroi letër Kryetarit të Gjykatës Komunale, në të cilën theksonte se nuk ishte e qartë se mbi bazën e cilës padi vepronte Gjykata dhe se padia e palës tjetër duhet të refuzohet si e pabazuar dhe e pambështetur me prova.
64. Më 10 tetor 2008, Gjykata Komunale e ftoi vetëm babain e parashtruesit në seancë, por jo edhe parashtruesin. Si rrjedhojë, parashtruesi iu ankua Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë se Kryetari i Gjykatës Komunale, duke vepruar në atë mënyrë, me qëllim kishte kryer shkelje thelbësore dhe absolute të Ligjit për procedurën kontestimore, për të cilat ai duhet të dënohet kurse rasti duhet të anulohet menjëherë.
65. Më 14 prill 2009, Gjykata e Qarkut e njoftoi parashtruesin se seanca për ankesë do të mbahej diku në maj 2009.
66. Më 8 qershor 2009, parashtruesi dorëzoi edhe një ankesë tjetër në Gjykatën e Qarkut, me të cilën kërkonte anulimin e aktgjykimit të paligjshëm të Gjykatës Komunale si joligjor dhe të pabazuar mbi bazën e “një prove ligjore për 17 vjet rresht”. Ai shtoi se “nëse nuk e miratoni padinë time si të ligjshme dhe të bazuar sipas të gjitha provave të nevojshme ligjore për më tepër se 30 vjet, që janë në pajtim me Vendimin Rev. nr. 19/03, të Gjykatës Supreme, të 24 prillit 2003, do të besoj që ju po u ndihmoni shkelësve të ligjit nga gjykata e shkallës së parë në Vushtrri”.
67. Më 12 qershor 2009, Kryetari i Gjykatës së Qarkut e njoftoi parashtruesin se do të thirrej të merrte pjesë në seancën kryesore në atë gjykatë. Data e seancës dhe vendimi pasues i gjykatës nuk i janë komunikuar Gjykatës Kushtetuese.
68. Më 31 janar 2011, parashtruesi mori një njoftim nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, në të cilin thuhej se ajo ia kishte kthyer lëndën Gjykatës Komunale në Vushtrri për rigjykim. Sipas mendimit të Gjykatës së Qarkut, *“Gjykata Komunale në Vushtrri ishte e obliguar t’i thërriste ndërgjyqësit në seancën e rigjykimit në mënyrë që ata t’i parashtronin pretendimet e tyre dhe më pas të merrte vendim të mirëfilltë si rezultat i fakteve të vërtetuara në mënyrë të drejtë e të hollësishme në proces të rregullt gjyqësor”*.
69. Duke pasur parasysh këto fakte, Gjykata thekson se ankesa e parashtruesit drejtuar Gjykatës së Qarkut kundër mënyrës në të cilën Gjykata Komunale e kishte zhvilluar procedurën, vërtetë ka qenë e suksesshme.
70. Sa i përket procedurës së rigjykimit në Gjykatën Komunale në Vushtrri, Gjykata Kushtetuese vëren që më 25 gusht 2011, Gjykata Komunale mori një njoftim nga Gjykata e Qarkut në të cilin thuhej se rasti gjyqësor nuk kishte përfunduar ende për shkak të mungesës së gjyqtarëve, dhe se vetëm Kryetari ishte emëruar gjatë fazës së tretë të emërimit të gjyqtarëve, i cili, më 27 maj 2011, kishte kërkuar nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ta delegonte një gjyqtar për t’i mundësuar Gjykatës Komunale që të vendoste për lëndën në rigjykim. Në mungesë të informacioneve të tjera nga Gjykata Komunale apo parashtruesi, Gjykata mendon që rasti është në procedurë në atë gjykatë.



71. Sa u përket këtyre procedurave në shqyrtim në Gjykatën Komunale në Vushtrri, Gjykata Kushtetuese vëren që parashtruesi nuk ka treguar deri më tani se ai ka ngritur ankesë kushtetuese, të cilën e ngrit tani në këtë Gjykatë, në këto procedura, e lëre më nëse ankesa e tij do të ishte refuzuar nga ajo Gjykatë Komunale, në procedurën e ankesës në Gjykatën e Qarkut, dhe, po të mos ishte e suksesshme, në Gjykatën Supreme, si instancë e fundit.
72. Në këto rrethana, Gjykata gjen që parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit.
73. Gjykata konkludon që ankesa e parashtruesit është e parakohshme dhe se kjo pjesë e kërkesës është e papranueshme.

### **Çështja e çezmës**

74. Sa i përket pretendimit në fjalë, Gjykata vëren që më 7 korrik 2008, parashtruesi ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë kundër Vendimit C. nr. 260/2008, të nxjerrë nga Gjykata Komunale në Vushtrri.
75. Në ndërkohë, më 3 maj 2011, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Vendimin AC. nr. 21/11, e refuzoi ankesën si të pabazë. Më 22 qershor 2011, parashtruesi e njoftoi Gjykatën Kushtetuese se nuk do të ushtronte ankesë kundër këtij vendimi.
76. Prandaj, Gjykata vëren që parashtruesi nuk ka ndërmend t'i ngrrejë në Gjykatën Supreme, si gjykatë e shkallës së fundit, shkeljet e supozuara të të drejtave të tij kushtetuese lidhur me çështjen e çezmës, të cilat i ka ngritur në këtë kërkesë.
77. Në këto rrethana, Gjykata duhet të konkludojë që, sa i përket kësaj pjese të kërkesës, parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.
78. Prandaj, kërkesa është e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, neneve 22.7, 22.8 dhe 47 të Ligjit, dhe rregullat 34 dhe 35 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese me shumicë

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Almiro Rodrigues



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani

